



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kuvendi i Komunës së Prizrenit

Nr. 001/011-73512

Më: 04 qershor 2024

Prizren



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafit 1 dhe 2 shkronja d) dhe nenit 17 paragrafit 1 shkronja k), dhe nenit 40 paragrafit 1 shkronja l) të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 06/2022 për themelimin dhe Funkcionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, si dhe neni 27 paragrafit 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 04 qershor 2024, miratoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS PËR EKIPIN KOMUNAL PËR TË DREJTAT
E FËMIJËS NË PRIZREN (2024-2026)

Neni 1

Miratohet Plani i punës për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës në Prizren (2024-2026) .

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i punës për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës në Prizren (2024-2026).

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Ky Vendim, hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PRIZRENIT / OPŠTINA PRIZREN / PRIZREN
BELEDIYESI / PRIZRENOSKI KOMUNA

PLANI I PUNËS
PËR
EKIPIN KOMUNAL PËR TË DREJTAT E
FËMIJËS
(2024 – 2026)

Prizren,
Maj 2024

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	3
FJALA E KRYETARIT	3
HYRJE	4
KONTEKSTI GLOBAL, NACIONAL DHE LOKAL	5
PARIMET DHE VLERAT	6
QËLLIMI YNË	8
FUSHAT E VEPRIMIT	8
OBJEKTIVAT, MASAT DHE VEPRIMET	8
1. Shërbimet cilësore gjithpërfshirëse për fëmijë	9
2. Vetëdijesimi dhe avokimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës	12
3. Hapësirat e sigurta dhe miqësore për fëmijë	13
4. Aktivitete: Sportive, kulturore, edukative, lojërave dhe rekreative për fëmijë	14
5. Pjesëmarrja e fëmijëve	15
6. Implementimi, monitorimi, vlerësimi dhe raportimi	16
SHTOJCA: PLANI I DETAJUAR I VEPRIMIT	Error! Bookmark not defined.

PARATHËNIE

FJALA E KRYETARIT

Plani i Punës për të Drejtat e Fëmijëve është një iniciativë gjithëpërfshirëse që synon përmirësimin e kushteve të jetesës dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të qytetit tonë. Në kuadër të Komunës së Prizrenit, përkushtimi ynë qëndron në nxitjen e një mjedisi të sigurt dhe edukues për fëmijët.

Nëpërmjet zbatimit të Planit të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve, objektivi ynë parësor është të kultivojmë ndërgjegjësimin në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe të trajtojmë në mënyrë proaktive sfidat që fëmijët hasin në jetën e tyre të përditshme.

Në qendër të agjendës sonë janë iniciativat e orientuara drejt rritjes së mundësive, sigurimit të qasjes së barabartë dhe cilësinë e shërbimeve komunale për çdo fëmijë. Kjo përfshin implementimin e aktiviteteve të dizajnuara për të nxitur mjedis të sigurt dhe të favorshëm me vëmendje të veçantë kushtuar mbështetjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Për më shumë, ne jemi vendosur për ta luftuar dhunën dhe abuzimin ndaj fëmijëve, duke adoptuar një qëndrim dhe reagim institucional me zero tolerance ndaj çdo forme të keqtrajtimit. Nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuëse në mbarë komunitetin, ne synojmë të ndërhyjmë menjëherë dhe të ofrojmë ndihmë dhe mbrojtje për fëmijët që përballen me vështirësi të tilla. Përpjekjet tona shtrihen edhe në promovimin e shëndetit dhe mirëqenies së fëmijëve. Kjo përfshin zbatimin e iniciativave shëndetësore parandaluese, promovimin e praktikave dhe aktiviteteve të shëndetshme, si dhe ofrimin e shërbimeve të mbështetjes psikologjike për fëmijët dhe familjet e tyre.

Njëkohësisht, investimet do të drejtohen drejt përmirësimit të infrastrukturës sportive, duke nxitur rritjen e pjesëmarrjes në aktivitete sportive në të gjitha grupmoshat. Kjo përfshin ndërtimin e fushave të reja sportive dhe mirëmbajtjen e hapësirave ekzistuese për praktikimin e sporteve. Për më tepër, një sërë aktiviteteve sportive, kulturore dhe me fokus rinor do të organizohen në mënyrë të vazhdueshme, duke i inkurajuar fëmijët të eksplorojnë dhe kultivojnë interesat e tyre.

Së bashku me këto përpjekje, ne mbetemi të përkushtuar përmbushjen e detyrimeve dhe investimin për të siguruar burimet e nevojshme për të përmbushur nevojat në zhvillim të fëmijëve.

Për fund, mirënjohje dhe falenderim i veçantë për përkushtimin dhe angazhimin e hartuesve të Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës në Prizren (2024-2026), Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, organizatave Nevo Konceptit, Save the Children Kosova/o dhe Syri i Vizionit.

Sinqerisht,
Shaqir Totaj
Kryetar i Komunës së Prizrenit

HYRJJE

Komuna e Prizrenit është e përkushtuar për sigurimin e mirëqenies së të gjithë qytetarëve të saj. Nëpërmjet politikave të mbështetura në vlera demokratike dhe transparencë, qeverisja komunale në Prizren ofron shërbime cilësore për të gjithë qytetarët pavarësisht përkatësisë, gjinisë apo aftësisë së tyre mbi çfarëdo baze.

Veçanërisht, fëmijët paraqesin grupin e qytetarëve që konsiderohen si kategori e veçantë për zhvillimin e të cilëve kërkohet mbështetje shoqërore dhe institucionale në drejtim të respektimit të drejtave të tyre. Duke pasur parasysh moshën e tyre, fëmijët ende nuk e kanë zhvillimin e plotë fizik, kognitiv e emocional dhe kështu varen nga të rriturit në gëzimin e të drejtave të tyre. Si Komunë ne jemi të vendosur të implementojmë politika dhe ofrojmë shërbime në drejtim të mbrojtjes të plotë të drejtave të fëmijëve. Komuna e Prizrenit synon të ofroj kushte adekuate për zhvillim të plotë të fëmijëve dhe të drejtave të tyre. Ky përcaktim, reflektohet në politikën qeverisëse të Komunës së Prizrenit e cila është miqësore për fëmijët.

Plani i Punës së Ekipit Komunal për të Drejtat e Fëmijës do të shërbejë si dokument pune për anëtarët e ekipit i cili është themeluar komuna për të definuar politikat dhe praktikat ndërsektoriale në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Plani i punës është hartuar në përputhje me standardet dhe praktikat e mbështetura në parimet demokratike, të parapara me legjislacionin nacional dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Dokumenti përmban fusha të detajuara të veprimit për institucionet relevante, të cilat janë të nevojshme për të siguruar realizimin e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.

Procesi i hartimit të planit të punës ka qenë proces dinamik dhe me pjesëmarrje të gjerë, përfshirë sektorët komunalë, institucionet qendrore, organizatat e specializuara në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, si dhe vetë fëmijët e organizuar në Asamblenë Komunale të Fëmijëve.

Disa nga veprimet që i kanë paraprirë hartimit të kësaj strategjie janë:

- Janë organizuar konsultime paraprake me palë të ndryshme që kanë ndihmuar në mbledhjen e informatave themelore dhe përgatitjen e procesit të planifikimit;
- Është organizuar një punëtori e planifikimit, ku janë identifikuar fushat e veprimit;
- Është organizuar konsultimi me përfaqësuesit e fëmijëve nga Asambleja Komunale e Fëmijëve;
- Është mbajtur një takim përcjellës me një grup të ngushtë punues në nivel komunal për të validuar përmbajtjen e planit të punës.

Procesi është udhëhequr nga Kryesuesi i Ekipi për të Drejtat e Fëmijës, njëherit kryetari i komunës së Prizrenit, z. Shaqir Totaj, ndërsa përkrahja është ofruar nga organizatat Nevo Koncepti dhe Save the Children Kosovë, me ndihmën e konsulentës të angazhuar.

KONTEKSTI GLOBAL, NACIONAL DHE LOKAL

Kushtetuta e Kosovës, në nivel të përgjithshëm përcakton mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kapitulli II i Kushtetutës rregullon të drejtat dhe liritë themelore duke rregulluar zbatimin e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën për të Drejtën e Fëmijës¹ e cila vendos standardet themelore në fushën e të drejtave të fëmijëve në nivel global. Kjo konventë u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara përmes rezolutës 44/25, me 20 nëntor 1989. Andaj, edhe parimet e kësaj konvente janë të parapara edhe me legjislacionin dhe politikat kombëtare përfshirë edhe hartimin e këtij plani të punës.

Në vitin 2019 është miratuar Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës e cila ka hapur rrugën operacionalizimit të tij përmes akteve nënligjore dhe krijimit e funksionimit të mekanizmave mbrojtës për fëmijët. Kështu Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës² ndër të tjera përcakton që Ekipi për të Drejtat e Fëmijës krijohet në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës në nivel të vendimmarrjes politike nëpërmjet udhëzimit administrativ 06/2022³. Krahas legjislacionit në fuqi ekzistojnë edhe strategji dhe plane kombëtare të cilat përfshijnë të drejtat e fëmijëve të cilat janë: Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026⁴ dhe Strategjia e Arsimit 2022-2026⁵.

Përkushtimi në nivel lokal ka reflektuar me politika dhe dokumente të përqendruara në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Komuna e Prizrenit bazuar në të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale dhe në mbështetje të dispozitave të Konvetës mbi të Drejtat e Fëmijëve në vitin 2019 ka miratuar Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve e cila përcakton procedurat dhe masat për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve në sistemin e qeverisjes komunale si dhe Rregulloren për Funksionimin e Institucioneve Edukative – Arsimore të Komunës së Prizrenit, miratuar më 2023.

Duke e pasur parasysh kompetencën e Komunës së Prizrenit, Kryetari i Komunës, në përputhje me UA 06/2022, më 7 prill 2023 ka nxjerrë vendim për themelimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës me qëllim të definimit dhe prioriteteve të komunës për përmirësimin e situatës në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe të koordinimit të aktiviteteve

Ekipi Komunal për të Drejtat e Fëmijës është i përbërë nga Kryetari i Komunës në cilësinë e kryesuesit të ekipit, drejtori i Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, në cilësinë e kryesuesit të ekipit, dhe nga një përfaqësues në cilësinë e anëtarit nga; Drejtorja e Arsimit dhe Shkencës, Drejtorja e Shëndetësisë, Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave, Komiteti për Politikë dhe Financa, Komiteti për Komunitete, Njësia për të Drejtat e Njeriut, Policia e Kosovës, Qendra për Punë Sociale, dhe nga Shoqëria Civile. Ndërsa në cilësinë e vëzhguesëve dhe këshilltarëve të jashtëm janë nga një përfaqësues nga; Përfaqësuesit e Fëmijëve (Asambleja Komunale e Fëmijëve), Kryesuesi/ja e Këshillit të Prindërve, Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit dhe OSBE.

Anëtarët e Ekipit Për të Drejtat e Fëmijës, institucionet lokale, organizatat të cilat veprojnë në komunën e Prizrenit dhe të gjithë qytetarët, janë përgjegjës për realizimin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm për realizimin e planit të punës. Kryetari i Komunës, Drejtoritë Komunale dhe Asambleja Komunale si institucione ekzekutive dhe legjislative në nivelin komunal do ti

¹ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës <https://www.ohchr.org/sites/default/files/crc.pdf>

² Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

³ Udhëzimi Administrativ 06/2022 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61596>

⁴ Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026, Zyra e Kryeministrit <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/plani-kombetar-per-zhvillim-2024-2026/>

⁵ Strategjia e Arsimit 2022-2026, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit <https://masht.rks-gov.net/strategjia-e-arsimit2022-2026/>

përshtasin politikat dhe do ti bashkërendojnë aktivitetet e tyre në mënyrë që të sigurohet interesi më i mirë i fëmijëve dhe mbrojtja e të drejtave të tyre.

Plani trevjeçar i punës i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës (2024 – 2026) është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, parimet e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, me politikat e nivelit qendror dhe lokal, gjithnjë duke u mbështetur në parimet e qasjes mike për fëmijët.

PARIMET DHE VLERAT

Në Komunën e Prizrenit promovohet modeli i qeverisjes lokale që u shërben pa dallim të gjithë qytetarëve të komunës, duke u ofruar në të njëjtën kohë mundësi të gjithëve të shprehin potencialin e tyre dhe të kontribuojnë aktivisht në mirëqenien e përgjithshme shoqërore. Një model i këtillë promovohet edhe në raport me fëmijët. Ata nuk janë marrës pasivë të shërbimeve të të rriturve por anëtarë aktivë të komunitetit. Si të tillë edhe trajtohen, duke i përfshirë në proceset komunale që lidhen me jetën e tyre dhe duke krijuar kushtet që të zhvillojnë gjithë potencialin e tyre. Si ekip e si komunë, jemi të përcaktuar që proceset në komunë të jenë jo vetëm “për fëmijët” por edhe “me fëmijët”.

Në punën tonë si ekip, udhëhiqemi nga parimet themelore të të drejtave të fëmijëve të cilat janë të mishëruara në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijës dhe Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës:

- **Mosdiskriminimi** - sipas të cilit parim, i garanton fëmijës të drejtat e plota pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij, apo përfaqësuesve të tij ligjorë. Andaj, të gjitha institucionet, ofruesit e shërbimeve, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, duhet të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit.
- **Interesat më të mira të fëmijës** - sipas të cilit të gjitha veprimet dhe vendimet, në të gjitha fazat, që kanë të bëjnë me fëmijën, të ndërmarra nga prindërit, institucionet dhe nga profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, duhet të jenë në interesin më të mirë të fëmijës dhe interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.
- **Jeta, mbijetesa dhe zhvillimi** – të gjithë fëmijëve duhet t’u sigurohet mbijetesa dhe zhvillimi deri në masën më të madhe të mundshme. Zhvillimi përfshin edhe dimensionin e cilësisë: jo vetëm shëndeti fizik, por edhe zhvillimi mental, emocional, kognitiv, social dhe kulturor.
- **Pikëpamjet e fëmijës** - fëmijët duhet të jenë të lirë të shfaqin pikëpamjet lidhur me çdo çështje që ndikon në ta dhe këtyre pikëpamjeve duhet t’u jepet peshë e duhur në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijëve.
- **E drejta e fëmijës për privatësi** – për çdo fëmijë, i cili dyshohet, apo edhe ka kryer një vepër penale dhe është nën moshën e përgjegjësisë penale, të gjitha procedurat që zhvillohen janë konfidenciale. Kjo përfshin, ruajtjen e identitetit të fëmijës, trajtimin konfidencial dhe konfidencialitetin e të dhënave në përgjithësi ndaj çdo pale të tretë, përfshirë edhe mas mediat dhe mediat sociale. Për të siguruar këtë të drejtë, institucionet duhet të marrin të gjitha masat për të garantuar konfidencialitetin e fëmijës në çdo rrethanë.

Ndërtimin e komunës mike për fëmijë e ushqejmë përmes **vlerave të përbashkëta**. Fëmijët kanë të drejtën për t'i shprehur lirisht pikëpamjet e tij, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë. Për më tepër vlerat tona lidhen me komunën ku fëmijët:

- Dëgjohen dhe kanë ndikim ku preket interesi i tyre;
- Krijojnë ndjenjën e përgjegjësisë ndaj vetes dhe të tjerëve;
- Janë të mbrojtur nga dhuna dhe çfarëdolloj diskriminimi;
- Ndihen të sigurt kudo që ata ndodhen;
- Përfshihen lirshëm;
- Luajnë e argëtohen;
- Krijojnë miqësi dhe ndihen të lidhur me komunitetin;
- Kanë mundësi për të mësuar, për të zhvilluar shkathtësitë;
- Ndihen të respektuar;
- Kanë mundësi për pjesëmarrje në shërbime sociale dhe shëndetësore.

QËLLIMI YNË

Komuna e Prizrenit është e përkushtuar për përmbushjen e të drejtave të fëmijëve të parapara me Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijëve, Konventën për të Drejtat të Fëmijës dhe aktet të tjera ligjore. Komuna e Prizrenit është e përkushtuar në dëgjimin e zërit, nevojve, dhe prioritizimin e të drejtave të tyre si pjesë integrale e politikave, programeve dhe vendimeve. Nëpërmjet bashkëpunimit ndërsektorial synohet zhvillimi i mirëqenies dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe krijimi i të drejtave të barabarta, të përshtatshme dhe mike për fëmijët.

FUSHAT E VEPRIMIT

Janë identifikuar 6 fusha të veprimit në kuadër të planit të punës, të cilat rrjedhin nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës. Fushat e veprimit paraqesin lidhshmëri dhe e plotësojnë njëra-tjerën, kështu duke nxitur bashkëpunim të vazhdueshëm ndërsektorial dhe duke ofruar një plan të punës i cili është efektiv, gjithëpërfshirës dhe i arritshëm për ta realizuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në komunën tonë.

OBJEKTIVAT, MASAT DHE VEPRIMET

Këto fusha prioritare, janë përkthyer në objektiva strategjike dhe më tutje përmbajnë masa që përmbushin këto objektiva. Secila masë brenda objektivit përkatës është zbërthyer më tutje në veprime konkrete, që shërbejnë si udhërrëfim në fazën e zbatimit të planit të punës.

- **Shërbimet cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijë**
- **Vetëdijesimi dhe avokimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës**
- **Hapësirat e sigurta dhe miqësore për fëmijë**
- **Aktivitete: Sportive, kulturore, edukative, lojëra dhe rekreative për fëmijë**
- **Pjesëmarrja e fëmijëve**
- **Implementimi, monitorimi, vlerësimi dhe raportimi**

1. Shërbimet cilësore gjithpërfshirëse për fëmijë

Ne duam t'i përmirësojmë shërbimet e sektorëve si mirëqenia sociale, arsimi, shëndetësia, shërbimet publike, duke i ofruar fëmijëve të komunës kushte më të mira të dhe duke e mbështetur zhvillimin e plotë të fëmijëve.

Vëmendje e veçantë do ti kushtohet kategorive të fëmijëve që kanë më së shumti nevojë siç janë fëmijët nga familjet që janë përfitues të skemave sociale, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në rrethana të jashtëzakonshme, etj. Krahas ofrimit të shërbimeve për fëmijët, do të ofrohet mbështetje për familjet dhe komunitetin përmes edukimit, dhe do të zhvillohen kapacitetet e profesionistëve të fushave të ndryshme me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve.

1.1 Krijimi i një sistemi informues shumëdimensional për llojet e shërbimeve sociale në komunë

Do të krijohet një sistem për ta informuar publikun lidhur me shërbimet që ofrohen në komunë. Fillimisht do të bëhet evidentimi i të gjitha shërbimeve ndaj fëmijëve dhe do të zhvillohet një katalog i llojeve të shërbimeve sociale që ofrohen.

Një fushatë informuese përmes institucioneve publike, mediave lokale, ueb faqes së komunës dhe kanaleve tjera të komunikimit në rrjetet sociale do të inicohet për promovimin e këtij katalogu.

1.2 Fuqizimi i konceptit të familjeve strehuese, përkujdesje rezidenciale dhe farefisnore

Ne do të ndërmarrim një fushatë për të rritur numrin e këtyre familjeve. Do të bëjmë identifikimin dhe vlerësimin e familjeve strehuese dhe farefisnore dhe do të trajnojmë këto familje si dhe trajtimi i fëmijëve brenda këtyre familjeve do të vazhdojë të monitorohet vazhdueshëm. Ndërsa për sigurimin e përkujdesjes sa më të mirë sociale ky aktivitet do të mbulojë bashkëpunimin e institucioneve të mirëqenies sociale për themelimin e objekteve për përkujdesje rezidenciale apo shtëpisë emergjente për mbrojtjen e fëmijëve e cila është shumë e nevojshme në kontekstin e komunës së Prizrenit duke pasur parasysh mbulueshmërinë e gjerë territoriale.

1.3 Fondi emergjent për fëmijët në rrethana të jashtëzakonshme

Fëmijët që gjenden në rrethana të jashtëzakonshme kërkojnë përkrahje institucionale në kuptim të ofrimit të shërbimeve profesionale, por edhe ofrimit të shërbimeve logjistike, siç janë ushqimi, transporti, akomodimi, etj. Për këtë arsye do të ndahet një fond emergjent për këta fëmijë dhe do të krijohet një sistem për menaxhimin e këtij financimi dhe këtyre shërbimeve emergjente. Do të evidentohen nevojat për shërbime emergjente dhe do të kontraktohen operatorët ekonomikë për ofrimin e këtyre shërbimeve.

1.4 Zhvillimi i praktikave të prindërimit të mirë dhe disiplinimit pozitiv

Modulet ekzistuese të prindërimit të mirë do të përshtaten për nevoja të komunitetit. Po ashtu, do të krijohen kapacitetet njerëzore, si dhe do të krijohen bashkëpunime me OJQ-të për ofrimin e moduleve të trajnimit dhe do të shpërndahen praktikat e prindërimit të mirë përmes trajnimeve e sesioneve të informimit.

1.5 Krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët për tu regjistruar, vijuar dhe përfunduar shkollën

Arsimi i obligueshëm nënkupton që çdo fëmijë i moshës shkollore ta vijojë shkollimin. Megjithatë, edhe në komunën tonë ballafaqohemi me raste të mosregjistrimit, mosvijimit të rregullt dhe braktisjes së shkollimit. Ne do të marrim masa për gjithëpërfshirje në shkollim. Do të krijohet një sistem i komunikimit mes shkollave dhe zyrave të regjistrimit civil për t'i marrë të dhënat e fëmijëve të moshës shkollore nga zona që gravitojnë shkollat, në mënyrë që të lehtësohet procesi i regjistrimit në shkollë. Shkollat do të mirëmbajnë bazën e të dhënave me të dhëna për nxënësit sipas modelit të Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA). Më tutje, do të realizohen takime të rregullta 3 mujore të Ekipit për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM), si dhe do të bashkëpunohet ngushtë me OJQ-të që punojnë në fushën e gjithëpërfshirjes në arsim.

1.6 Ofrimi i shërbimeve profesionale nëpër shkolla

Do të trajnohen mësimdhënësit për identifikimin e hershëm dhe referim të fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale pedagogjike dhe psikosociale. Çdo shkollë duhet të instalon shërbime adekuate profesionale për trajtim dhe mbështetje të fëmijëve. (Do të krijohet/funksionalizohet mekanizmi për referimin e fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale.) Po ashtu do të identifikohen nevojat për mësimdhënës mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe do të angazhohen këta mësimdhënës në shkollat e komunës.

1.7 Inspektimi i cilësisë së hapësirave shkollore

Gjendja e objekteve shkollore reflekton dhe ndikon në cilësinë e arsimit. Prandaj, ekipet profesionale/inspektorët do ta inspektojnë gjendjen e shkollave në baza tre mujore (inspektim të vjetërsisë së objekteve, sanitarisë, hapësirave për lojë e rekreacion, pajisjeve shkollore, etj). Këto ekipe pas inspektimit të objekteve shkollore do të dalin me raporte vlerësuese. Mbi bazën e raporteve do të ndërmerren masa përmirësuese me qëllim të krijimit të objekteve dhe mjediseve shkollore miqësore për fëmijë. Standardet e shkollave mike për fëmijë do të promovohen vazhdimisht.

1.8 Krijimi i mekanizmave brenda shkollave për mirëmbajtje të mjediseve shkollore

Edukimi duhet ta ketë pjesë të saj të vazhdueshme mirëmbajtjen e objekteve shkollore në mënyrë që t'iu ofrohet fëmijëve një ambient mik dhe ekologjik. Prandaj për të siguruar angazhimin e të gjitha palëve të shkollave në këtë drejtim, do të vetëdijesohen nxënësit dhe mësimdhënësit për nevojën e mirëmbajtjes dhe kujdesin ndaj mjedisit shkollor. Do të hartohet një udhëzues me praktika të mira të mirëmbajtjes së hapësirave shkollore dhe do t'iu ofrohet mbështetje në baza vjetore shkollave për organizimin e aktiviteteve kreative lidhur me mirëmbajtjen e hapësirave të shkollës. Në bazë të mbështetjes për aktivitete kreative do të ndahen shpërblime për shkollat me mjedis më të mirëmbajtur.

1.9 Promovimi shëndetësor, përmes informimit, komunikimit dhe edukimit

Do të promovohet shëndeti përmes fushatës vetëdijesuese për shëndetin dhe të ushqyerit e foshnjave, fëmijëve dhe adoleshentëve, si dhe përmes edukimit shëndetësor të qytetarëve e ligjëratarave për edukimin shëndetësor dhe reprodutiv për nxënësit e shkollave. Me qëllim të ofrimit të shërbimeve sociale dhe mbulueshmërisë më të madhe të përfituesve, do të ofrohen grante për organizatat të cilat punojnë në ofrimin e shërbimeve sociale, përkrahje për shëndet mendor, promovim të mirëqenies sociale nëpërmjet Drejtorisë për Mirëqenie Sociale. Njëashtu, do të organizohen ligjërata tematike në shkolla për parandalimin e abuzimit me substanca.

1.10 Organizimi i vizitave multidisiplinare shëndetësore për fëmijët, në baza periodike

Do t'i kushtohet kujdes ofrimit të shërbimeve të individualizuara shëndetësore për secilin fëmijë. Prandaj do të zhvillohen kapacitetet e profesionistëve shëndetësorë për kujdes shëndetësor ndaj nënës dhe fëmijës, këshillim për të ushqyerit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël dhe përkrahje të zhvillimit në fëmijërinë e hershme. Do të organizohet shërbimi i vizitave sistematike nëpër shtëpi, të cilat do të kenë përveç komponentit të intervenimit shëndetësor edhe atë edukativ. Do të zbatohen praktikat efektive të kujdesit perinatal dhe vizitave për nënat dhe fëmijët. Kontrollat sistematike shëndetësore do të realizohen edhe nëpër shkolla.

1.11 Identifikimi i hershëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara

Do të hartohet dhe përdoret një formular për deklarimin e prindit për gjendjen shëndetësore të fëmijës, gjatë regjistrimit në shkollë. Për ata fëmijë që kanë parametra që identifikojnë nevojën për kontroll më të hollësishëm, do të ndërmerren vlerësime dhe do të rekomandohen masa që duhet ndërmarrë shkolla (mësimdhënësit, menaxhmenti i shkollës, prindërit).

1.12 Ofrimi i shërbimeve për kategoritë e fëmijëve në nevojë

Do të ofrohen shërbime shumëdimensionale dhe rehabilitim i bazuar në bashkësi për FNV, përmes subvencionimit të organizatave të licencuara për ofrimin e këtyre shërbimeve. Do t'i kushtohet kujdes sigurimit të qasjes fizike të fëmijëve me aftësi të kufizuara në hapësirat publike duke i paraprirë me identifikimin e nevojave për sigurimin e qasjes fizike. Më tutje do të ofrohen programe të mbështetjes shtesë për fëmijët nga grupet e cenueshme (komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, fëmijët në situatë rruge/lëmshëkërkuesit, fëmijët që punojnë, fëmijët viktimë të trafikimit, etj.). Programe të tilla do të jenë mësimi shtesë përmes qendrave mësimore dhe qendrave ditore, qendrat burimore për fëmijë me aftësi të kufizuara, dhe shkolla speciale, përfshirja në aktivitete rekreative të qendrave rinore, sesione këshillimi, etj.

2. Vetëdijesimi dhe avokimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

Ne duam që nëpërmjet bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me partnerët tanë, të kontribuojmë në zhvillimin e sistemit efektiv informues dhe të vetëdijësimit për të rriturit, dhe fëmijët lidhur me të drejtat e fëmijëve, mirëqenien e tyre dhe komunën mike. Fokus të veçantë do ta kenë programet për informim dhe zhvillim profesional për të gjitha palët duke përfshirë edhe politikëbërësit e zyrtarët më të lartë komunalë. Në të njëjtën kohë, ne do t'i inkurajojmë organizatat e shoqërisë civile, grupet e fëmijëve, agjencitë e pavarura që të avokojnë për fëmijët. Ndërkaq, do të shfrytëzohen kanalet mediatike, të rrejteve sociale dhe përfshirja e komunitetit në promovimin e të drejtave të fëmijës.

2.1 Ngritja e kapaciteteve zyrtarëve komunalë lidhur me të drejtat e fëmijëve

Me rëndësi konsiderohet që zyrtarët komunalë si bartës të funksioneve, të jenë mirë të informuar dhe zhvilluar aftësi për vlerësim dhe mbështetje të nevojave të fëmijëve. (të kenë aftësi vlerësimi e gjykimi për në fushën e të drejtave të fëmijëve.) Prandaj, do të organizohen trajnime me tema (fusha tematike) të lidhura me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, promovimit të drejtave të fëmijëve, instrumenteve ndërkombëtare, legjislativës dhe rregullativës që lidhet me të drejtat e fëmijëve, vlerësimit dhe raportimit të gjendjes së fëmijëve, standardeve të operimit, investimit publik në fëmijë, etj.

2.2 Organizimi i fushatave vetëdijesuese për të rriturit dhe për fëmijët

Qytetarët duhet të vetëdijësohen për atributet e komunës mike për fëmijë dhe të aktivizohen si qytetarë të përgjegjshëm. Prandaj në bashkëpunim me OJQ-të, grupet e fëmijëve dhe të rinjëve do të organizohen fushata vetëdijesuese për të rritur dhe fëmijë për vetëdijësimin dhe informimin e tyre. Fushatat do të përfshijnë ligjëratat publike, aktivitete promovuese nëpërmjet mjeteve informuese, shënimin e ditëve kushtuar të drejtave të fëmijëve etj. Ndërsa për fëmijë do të ofrohen programe të ligjëratave për të drejtat e njeriut dhe qytetarinë demokratike brenda kurrikutit shkollor dhe përmes edukimit joformal.

2.3 Zbatimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës në të gjitha Institucionet para-universitare

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës është zotimi dhe përgjegjësia e institucionit për të garantuar dhe siguruar mbrojtjen e fëmijës, përmes dijes dhe punës profesionale, etikës së punës, aftësisë dhe shkathtësisë të personelit të institucionit arsimor, për të identifikuar dhe parandaluar rreziqet dhe dëmet, për të vlerësuar me kompetencë ngjarjet, si dhe për të reaguar në përputhje (përshtatshëm) me rrethanat e ngjarjes dhe fëmijën. Qëllimi i kësaj politike është krijimi i një mjedisi të sigurtë për të gjithë fëmijët në institucionet e arsimit para-universitar publik dhe privat në Kosovë, duke vendosur parime dhe rregulla, të cilat duhet respektuar denjësisht. Politika e mbrojtjes, e fuqizon punën, përkushtimin, rregullin, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien brenda institucionit edukativ, arsimor dhe aftësues, si dhe në raport me autoritetet tjera.

2.4 Mbështetja e organizatave joqeveritare, Asamblesë Komunale të Fëmijëve dhe institucioneve të pavarura në avokimin për të drejtat e fëmijës

Ne do të jemi transparentë dhe të gatshëm për të shqyrtuar e për adresuar opinionet e të gjitha palëve, lidhur me qeverisjen komunale. Në raport me plotësimin e detyrimeve komunale për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve komuna dhe të

mbështesë Asamblesë Komunale të fëmijëve, organizatat joqeveritare, koalicionet e organizatave, grupet e fëmijëve dhe grupet e të rinjve të cilët punojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe fëmijëve në promovimin e të drejtave të fëmijëve në nivel komunal. Për më shumë, do të përkrahet puna e tyre nëpërmjet skemës së granteve.

2.5 Promovimi i të drejtave të fëmijës përmes medias

Shfrytëzimi i medimeve të ndryshme për të plasuar ose ofruar (gjeneruar) lajme të përgjegjshme për fëmijët dhe në interesin më të mirë të tyre është shumë i rëndësishëm. Për të siguruar këtë, do të ofrohen udhëzues dhe trajnime për zyren komunale për marrëdhënie me publikun, për sekretariatit e ekipit si dhe për mediat e profesionistët e mediave të shkruara dhe elektronike. Do të përkrahen mediat që të promovojnë të drejtat e fëmijëve dhe që të paraqesin gjendjen e fëmijëve në mënyrë transparente e reale. Po ashtu, do të organizohen forume diskutimi në mes komunës dhe mediave lidhur me standardet për mbrojtjen e identitetit dhe integritetit të fëmijëve

3. Hapësirat e sigurta dhe miqësore për fëmijë

Komuna e Prizrenit është e përkushtuar që hapësirat e frekuentuara nga fëmijët të jenë plotësisht të sigurta për ta dhe t'u krijojnë atyre ndjenjën e sigurisë në çdo kohë. Komuna do të përfshijë aktivisht fëmijët dhe prindërit në konsultime gjatë planifikimeve të investimeve urbanistike, do të përmirësojë higjienën kolektive, do të krijojë kushte për qarkullim të të sigurtë në trafik, do të shmang rreziqet në hapësira publike dhe do të krijojë mjedis ekologjik.

3.1 Sigurimi i sistemit të trafikut që është i sigurt dhe miqësor për fëmijët

Në komunë, trafiku është i ngarkuar me numër të madh të automjeteve dhe vuan nga problemet me parkingje, semaforë, rregullimi i ndriçimit publik, shtigje për këmbësorë dhe rregullimin e shtigjeve për biçiklista konform legjislacionit në fuqi. Kjo situatë në rrugë më së shumti i kërcënon fëmijët të cilët frekuentojnë rrugë të ndryshme gjat lëvizjes së tyre të përditshme. Për të përmirësuar këtë situatë, do të hartohen dhe zbatohen projekte për lirim të trotuareve dhe vendkalimeve për këmbësorë, vendosjen e shenjave të vendkalimeve, vendosjen e barrierave, rregullimin shtigjeve të biçiklistëve, etj. Ndërkaq, me të gjithë pjesëmarrësit në trafik do të ndërmerret një fushatë informimi për sigurinë në trafik.

3.2 Eliminimi i rreziqeve dhe krijimi i mjedisit ekologjik

Hapësirat publike të pa rregulluara dhe të dëmtuara përbëjnë rrezik për fëmijët. Prandaj, do të monitorohen në mënyrë sistematike hapësirat publike për të identifikuar rreziqet eventuale për fëmijët (parqet, shtretërit e lumenjve, deponitë, rrënojat, gropat e pusetat e pambuluara, trotuarët e vendkalimet e pashenjuara, lodrat për fëmijë, etj.) dhe do të merren masa për eliminimin dhe rregullimin e tyre. Komuna do të mbështetet edhe në ndihmën e publikut në raportimin e rreziqeve të tilla. Raportimi do të ndodhë nëpërmjet linjës për thirrje pa pagesë të komunës e cila është e publikuar në web-faqen e komunës. Do të promovohet linja telefonike për publikun për raportimin e rreziqeve.

Për shkak të koncentrimit të madh të fëmijëve rreth shkollave, do të merren masa për të parandaluar rreziqet përreth shkollës, që mund të vijnë nga prania e personave të dyshimtë, shitja e artikujve të dëmshëm, etj. Kontrollat e rregullta në ambientet përreth shkollave do të realizohen në bashkëpunim të komunës me Policinë e Kosovës. Ndërsa Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, nëpërmjet drejtorëve të shkollave do të bashkëpunojë me policinë mbi raportimin e rasteve të shitjes së produkteve të ndaluara për fëmijë në afërsi të shkollave. Po ashtu në nivel komune dhe në bashkëpunim edhe me nivelin qendror do të punohet mbi

sistemimin e qenve endacakë, rregullimin e sistemit të kamerave në rrugët e qytetit, inspektimin dhe mbikqyrjen e shitësve ambulantiv pranë shkollave. Komuna dë to kontribuojë në rritjen e hapësirave të gjelbra dhe parqeve në qytet.

4. Aktivitete: Sportive, kulturore, edukative, lojërave dhe rekreative për fëmijë

Loja, rekreacioni dhe sporti janë elemente të rëndësishme të zhvillimit të fëmijëve dhe segmente ku zhvillojnë kreativitetin e tyre, mësojnë dhe shfaqin talentet. Komuna do të promovoj pjesëmarrjen e fëmijëve nëpër klube sportive e aktivitete kulturore. Shkollat do të jenë institucionet që përtej kurrikulit formal do të krijojnë dhe ofrojnë hapësira dhe mundësi për aktivitete të kohës së lirë, rekreacion e sport për nxënësit. Ndërsa komuna do të kontribuojë në pasurimin e parqeve në nivel të lagjeve me paisje që ofrojnë mundësi të praktikimit të sporteve të ndryshme.

Shkollat njëashtu do të krijojnë bashkëpunime me klubet sportive, klubet artistike e kulturore, në mënyrë që fëmijët të mund t'i zhvillojnë dhe praktikojnë në mënyrë të pa-kushtueshme talentet e tyre në fushat në të cilat shprehin interesim.

4.1 Promovimi i sportit nëpër shkolla

Në nivel të shkollave do të zhvillohen kapacitetet njerëzore që do të marrin përgjegjësinë e promovimit të sportit shkollor. Ndërsa DKA do ta udhëheq procesin e krijimit të bashkëpunimeve me klubet sportive ekzistuese dhe shkollave të komunës. Do të inicohet krijimi i klubeve sportive në nivel të shkollave dhe do të organizohen gara shkollore në sporte të ndryshme. Rëndësi do t'i kushtohet përfshirjes gjinore dhe thyerjes së stereotipeve gjinore.

4.2 Funkcionalizimi i klubeve sportive të kategorive të reja

Do të punohet me klubet sportive ekzistuese në aktivizimin e grupeve për kategoritë e reja për vajza dhe djem si dhe do të mbështetet krijimi i klubeve të reja sportive. Për të rekrutuar fëmijë dhe të rinj në klube, do të bashkëpunohet me shkollat dhe do të mbahen kampe të përbashkëta në baza vjetore për identifikimin e talenteve.

4.3 Promovimi i artit, kulturës, teknologjisë dhe inovacionit

Do të ofrohen programe artistike e kulturore nëpër shkolla, ku fëmijët do të demonstrojnë shkathhtësitë e tyre. Klubet artistike e kulturore të shkollave do të bashkëpunojnë me organizata të artit e kulturës si teatro, ansamble të këngëve e valleve, klube letrare, klube të teknologjisë, krijimtarisë artistike si punë dore, pikturë etj., për të ofruar mundësi shtesë për fëmijët që kanë interes në këto fusha. Po ashtu, do të përkrahen shkollat dhe institucionet në promovimin e hapësirave për programim, kodim, ueb dizajn, etj. Komuna do të përkrahë garat në këto fusha për ti nxitur kreativitetin dhe angazhimin e fëmijëve dhe për ti motivuar ata. Praktika të tilla tashmë janë instaluar përveç në nivel të shkolla do të zhvillohen më tutje nëpërmjet përkrahjes së këtyre klubeve dhe iniciativave ekzistuese.

4.4 Ofrimi i hapësirave joformale për rekreacion

Lagjet tona duhet të ofrojnë hapësira të rekreacionit ku fëmijët mund të çlodhen e shoqërohen. Për këtë arsye, do të inspektohet situata me parqet ekzistuese dhe do të

identifikohen nevojat për hapësira shtesë për lojë, fusha të sportit të shfrytëzueshme për të gjithë. Më tutje, do të intervenohet në adaptimin e hapësirave ekzistuese për lojë dhe në ndërtimin e hapësirave të reja për argëtim. E gjithë kjo do të bëhet në përputhje me standardet e hapësirave të sigurta e mike për fëmijë. Do të krijohet një partneritet mes komunës dhe komunitetit me bazë në lagje dhe këshillat lokal duke krijuar ekipet e përbashkëta për mirëmbajtjen e hapësirave rekreative. Për t'i kthyer këto hapësira komunitare në hapësira përfshirëse, do të bëhet identifikimi i nevojave për rekreacion i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe përfshirja e tyre në parqet ekzistuese.

4.5 Angazhimi i fëmijëve në aktivitete të lira në të mirë të komunitetit

Fëmijëve do ti ofrohen mundësi kohën për rekreacion ta shfrytëzojnë për aktivitete që janë me përfitim për komunitetin. Kësisoj ata i zhvillojnë vlerat qytetare dhe përgjegjësinë për komunitetin. Komuna do të përkrah organizimin e aktiviteteve në ditore dhe afatgjate me fëmijë dhe të rinj nga shkollat e ndryshme, por edhe atyre nga organizatat e fëmijëve dhe Asamblenë e Fëmijëve. Këto aktivitete do të jenë të natyrës rekreative, edukative, mjedisore, inovative etj. Komuna do të angazhohet në krijimin e një Qendre Rinore në ndonjërin nga fshatrat. Një analizë e nevojave do të realizohet për zgjedhjen e lokacionit të kësaj qendre. Do të organizohen vizita e takime edukative e kulturore në institucionet që mbrojnë të drejtat e fëmijëve, në mes të grupeve të fëmijëve dhe fëmijëve të tjerë nga të gjitha shkollat. Më tutje, do të bëhet angazhimi i fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete në përfitim të komunitetit si mbjellja e drunjëve, ofrimi i ndihmës së parë, evakuimi, siguria në trafik, etj.

5. Pjesëmarrja e fëmijëve

Ne jemi të përkushtuar për ofrimin e mundësive sa më të përshtatshme për pjesëmarrjen e fëmijëve aktive në procese të vendimmarrjes në nivel komunal. Do të ofrojmë mbështetje që edhe familjet ta praktikojnë këtë qasje që nga fëmijëria e hershme. Duke e konsideruar rolin e rëndësishëm të institucioneve arsimore në fuqizimin e fëmijëve në pjesëmarrje nëpërmjet tyre do të fuqizohen praktikat ekzistuese për përfaqësimin e fëmijëve në nivele të ndryshme dhe do t'u ofrohet hapësirë veprimi dhe përkrahje në zhvillimin e kapaciteteve të tyre. Organet vendimmarrëse në të gjithë sektorët e komunës do të ndjekin procedurat e konsultimeve me fëmijë para se të marrin vendime që ndikojnë në jetën e fëmijëve.

5.1 Promovimi i zbatimit të procedurave të konsultimit me fëmijët me rastin e vendimmarrjes ku preket interesi i fëmijës

Do të promovohen procedurat për konsultimin e fëmijëve për të gjitha akterët relevant në komunë që marrin vendime për fëmijët dhe në përgjithësi për qytetarët e komunës. Këto procedura do të paraqiten përmes një udhëzuesi praktik. Do të monitorohet zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijë nga të gjithë sektorët komunalë me rastet e hartimit të projekteve zhvillimore, strategjive e planeve të veprimit, me rastin e planifikimit të buxhetit, etj.

5.2 Fuqizimi i organeve përfaqësuese të fëmijëve

Këshillat e nxënësve janë organe të nxënësve të parapara me ligj, njëashtu është edhe Asambleja Komonale e Fëmijëve. Ndonëse këshillat e nxënësve janë të themeluara në të gjitha shkollat, funksionimi i tyre duke përfshirë mënyrën e përzgjedhjes dhe mandatin e angazhimit të tyre nuk i përmbahen gjithnjë parimeve demokratike gjithpërfshirëse.

Komuna nëpërmjet DKA-së do të nxit funksionimin e rregullt të organeve përfaqësuese të nxënësve në të gjitha nivelet, duke filluar nga këshillat e nxënësve nëpër klasa, e deri te Asambleja Komunale e Fëmijëve. Këto organe duhet të jenë gjithëpërfshirëse në kuptim të përfaqësimit gjinor, gjeografik, etnik, të aftësive, etj. Më tutje, do të zhvillohen kapacitetet e fëmijëve për pjesëmarrje demokratike në jetën shkollore dhe të komunitetit, përmes moduleve të trajnimit për udhëheqje dhe për aktivizim qytetar. Një aspekt qenësor është rregullimi i marrëdhënieve në mes vetë nxënësve. Për këtë arsye do të promovohet ndërmjetësimi në mes moshatarëve si qasje për të adresuar problemet dhe konfliktet, si dhe do të vazhdoj bashkëpunimi ndërsektorial për adresimin e ngacmimeve, dhunën në shkollë, në lagje dhe në të gjitha ambientet ku fëmijët mund të ndodhen.

6. Implementimi, monitorimi, vlerësimi dhe raportimi

Ne synojmë (duam) që i gjithë procesi i zbatimit të planit të punës të refletojë qeverisjen e mirë dhe miqësore për fëmijë. Prandaj, është me shumë rëndësi që (ky proces të jetë me pronësi të gjerë,) të gjitha palët mbajnë përgjegjësi dhe të bashkërendojnë veprimet me qëllimin që të adresohen masat e përcaktuara (definuara) me planin e punës. Ndërsa, për të siguruar cilësinë na nevojitet zhvillimi i instrumenteve për vlerësimin e ndikimit në fëmijë, dhe hartimi i raporteve për gjendjen e fëmijëve të komunës.

Për sigurimin e implementimit efektiv të këtij plani të punës, Komuna e Prizrenit është e përkushtuar në ofrimin e mbështetjes institucionale për sektorët relevant. Veprimet, aktivitetet dhe vendimet do të adresohen në bashkëpunim ndërsektorial me qëllim të arritjes së përbushjes së objektivave të këtij plani. Për sigurimin e cilësisë së implementimit të planit, do të jipet vëmendje e veçantë monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm, të cilat do të rezultojnë me raporte të qasshme për të gjithë qytetarët, të cilët do të informohen mbi punën dhe rezultatet e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës.

6.1 Implementimi dhe përgjegjësit

Plani i punës i mbulon të gjitha aktivitetet komunale që sigurojnë mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve. Institucionet lokale të cilat punojnë me mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve në komunën e Prizrenit parashihet të përbush parimet dhe objektivat e këtij plani përfshirë edhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e fëmijës duke u kujdesur që të mbrohet interesi më i mirë i fëmijës. Përfituesit primarë të këtij plani janë fëmijët, ndërsa implementimi i aktiviteteve shumëdimensionale i përket Komunës së Prizrenit, përfshirë anëtarëve të Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve, institucioneve lokale, zyrtarëve, qytetarëve dhe OJQ-ve. Hartimi i dokumentit është realizuar duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-084 “Për Mbrojtjen e Fëmijës”, specifikon përgjegjësinë institucionale lidhur me përbushjen e të drejtave të fëmijëve, dhe përcakton rëndësinë e kordinimit ndërsektorial në fushën e të drejtave të fëmijës.

Ky plan i punës është i plotfuqishëm pas miratimit nga Asamblesë Komunale.

6.2 Raportimi i planit të punës

Procesi i implementimit të planit të punës ka nevojë ti nënshtrohet vlerësimit dhe matjes së ndikimit që ka arritur për fëmijët. Prandaj, bazuar në përgjegjësitë e institucioneve dhe aktiviteteve të parapara në baza periodike me këtë plan të punës, do të bëhet raportimi periodik i ndikimit. Raportimi i ekipit do të bëhet në baza 6 mujore tek Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, sikurse është e paraparë edhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2022. Raportet njëashtu do të diskutohen në nivel të ekipit komunal dhe praktikant më të mira do të përfshihen në politikat dhe praktikant e qeverisjes lokale.

6.3 Koordinimi me palët relevante

Ekipi për të Drejtat e Fëmijës takohet në baza 3 mujore dhe do të mbaj komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me palët e ndryshme si në nivelin lokal ashtu edhe në nivelin rajonal dhe qendror. Kështu duke kontribuar në implementimin e politikave mike për fëmijët.

6.4 Monitorimi dhe Vlerësimi

Monitorimi do të jetë pjesë e vazhdueshme e implementimit të këtij plani të punës. Të gjithë anëtarët e ekipit do të kontribuojnë në matjen e rezultateve dhe monitorimin e tyre. Monitorimi i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës në Komunën e Prizrenit do të bëhet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyra për Qeverisje të Mirë pranë zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Ndërsa në fund të periudhës së zbatimit të planit trevjeçar, Ekipi për të Drejtat e Fëmijës do ta hartoj raportin përfundimtar të zbatimit të këtij plani i cili do të shërbejë si burim për planifikim të ardhshëm.

SHTOJCA 1 : PLANI I DETAJUAR I VEPRIMIT

Plani i detajuar i veprimit (me bartësit, shtrirjen kohore, nevojat buxhetore dhe burimet e financimit) është dhënë si shtojcë në një dokument Excel)

Shënim Zyrtar: Ky plan i punës, është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, të mbajtur më 04 qershor 2024.

Kryesuesja e Kuvendit
Anëgonë Bytyqi

